

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Novobërda – Raporti komunal

Nëntor 2009

## Novobërda në shifra

<b>Popullsia</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>3,567</b>
	Shqiptarë	59.2%
	Serbë	39.4%
	Të tjerë	1.4%
<b>Gjeografia</b>	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	91.6
	Numri i fshatrave	14
<b>Shkollimi</b>	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	22%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	48%
	E mesme	26%
	Shkollë e lartë	4%
	Universitet	0%
	Nr. i nxënësve	351
	Nr. i mësimdhënësve	33
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	1
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	5
	Nr. i çerdheve	0
	<b>Shëndetësia</b>	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		3
Nr. i mjekëve		1
<b>Papunësia</b>	Gjithsej	43.70%
	Meshkuj	38.69%
	Femra	57.18%
<b>Të punësuar</b>	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	2,176
	Të punësuar në sektorin publik komunal	157
<b>Buxheti 2009</b>	Gjithsej (Euro)	1,018,739
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	17,700
	Të hyrat tjera (Euro)	1,001,039
<b>Shpenzimet e realizuara (2008)<sup>1</sup></b>	Gjithsej (Euro)	476,984 (81%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	3,927 (98%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	473,057 (79%)
<b>Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007</b>	PDK	49.29%
	LDK	40.40%
	LDD	9.95%
	Tjera	0.36%
<b>Kryetarët e Komunës 2000-2009</b>	2000-2002: Emin Gërbeshi (PDK) 2002-2007: Tihomir Bogdanovic (KP) 2007-2009: Bajrush Ymeri (LDK)	

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Novobërdën

“Kur Novobërda ishte qytet, Londra ishte fshat.” Në shumë libra të historisë kështu përshkruhet lokaliteti ku tani ndodhet komuna e Novobërdës. Është fakt se në Novobërdë ka funksionuar një nga minierat më të mëdha për përpunimin e argjendit në tërë Evropën mesjetare. Ky lokalitet njihet edhe për pasuritë e shumta nëntokësore, siç janë ari, argjendi, plumbi, zinku, etj. Nga kjo lavdi e lashtë historike tani ka mbetur vetëm Kalaja e Novobërdës, e cila është një nga kalatë më të vjetra dhe më e vizituara në Kosovë. Novobërda, apo Artana siç quhet jo zyrtarisht, është një nga komunat me numrin më të vogël të banorëve. Në territorin e kësaj komune jetojnë më pak se 4,000 banorë. Territori dhe numri i popullsisë është rritur pas decentralizimit, ku 9 zona kadastrale të Gjilanit dhe 3 të Kamenicës i janë bashkuar Novobërdës. Në përgjithësi komuna është e pa zhvilluar ekonomikisht. Një nga shpresat më të mëdha që ka kjo komunë për tu zhvilluar ekonomikisht është ndërtimi i një rruge më të përshtatshme që do të lidhte Kamenicën me fshatin Llabjan (rruga magjistrale Gjilan-Prishtinë), apo edhe turizmi malor i cili ka filluar të ngjallet.

## Problemet aktuale

Novobërda ka popullsi të përzier etnikisht, ku shumicën e përbëjnë shqiptarët me 59.2%, serbët me 39.4% dhe romët me 1.4%. Këto shifra pritet të përmbysen pas procesit të decentralizimit, ku 13 zonat e reja kadastrale që do ti bashkohen Novobërdës janë me shumicë serbe. Qytetarët e kësaj komune përballen me probleme të shumta, siç është papunësia, varfëria, zhvillimi i ulët ekonomik, mungesa e transportit publik, uji i pijes, etj. Nga numri i përgjithshëm prej 3,567 banorëve, 61% janë të aftë për punë (15-64 vjeç). Në Qendrën Komunale për Punësim janë të regjistruar 1,031 punëkërkues apo 47.3% e popullsisë së aftë për punë. Kjo shifër njëherit paraqet edhe përqindjen më të madhe të punëkërkuesve të regjistruar në përpjesëtim me numrin e popullsisë. Mirëpo, shifrat reale të papunësisë besohet që janë më të larta se 47.3%, pasi që një numër i punëkërkuesve nuk regjistrohen në Qendrën Komunale për Punësim, pasi që nuk kanë besim se do të kenë ndonjë përfitim nga kjo. Novobërda paraqet komunën me numrin më të lartë të familjeve që janë të varura nga ndihmat sociale. 153 familje me 648 anëtarë (apo 18.1% e popullsisë) janë të varur nga ndihmat sociale. Shumë familje përballen edhe me probleme të shumta për banim, pasi që shtëpitë e tyre janë të vjetruara dhe ta pa mirëmbajtura. Në mars të këtij viti, Qeveria e Kosovës ka ndarë 543,000 € për renovimin dhe rindërtimin e 29 shtëpive në këtë komunë. Do të rindërtohen 13 shtëpi të romëve, e që është numri total i familjeve rome në këtë komunë, 8 shtëpi të familjeve serbe dhe 8 shqiptare. Ky projekt pritet të lehtësoj sadopak problemin e banimit për 29 familje. Përveç këtyre problemeve, banorët e kësaj komune përballen edhe me:

- Mungesë të rrjetit të ujësjellësit;
- Mungesa e transportit publik;
- Ujërat e zeza dhe mbeturinat;
- Dëmtimi i ambientit nga puna e gurëthyesit;
- Mungesa e kujdesit ndaj Kalasë dhe objekteve tjera me rëndësi kulturore dhe historike;

**Mungesa e ujit të pijes.** Shqetësimi kryesor i banorëve të disa lokaliteteve të Novobërdës është mungesa e ujit të pijes. Me këtë problem më së shumti përballen

banorët në qendrën e qytetit, sidomos ata që banojnë në banesat kolektive, banorët e fshatit Bunjak, logjet Kolonia e Re dhe Kolonia e Vjetër, Pllavica dhe qyteti i vjetër. Zgjidhja e këtij projekti mund të bëhet vetëm me bashkëpunim të komunës me nivelin qendror apo donatorët, ngase kapacitetet financiare të kësaj komune janë shumë të vogla.

**Mungesa e transportit publik.** Edhe pse një komunë me pozitë të mirë gjeografike, rrugët kryesore për qarkullim të automjeteve e kanë anashkaluar këtë komunë. Kjo për arsye të terrenit malor. Rruga kryesore që përshkon Novobërdën nga udhëkryqi në fshatin Llabjan e deri në kufi me komunën e Kamenicës është ndërtuar shumë vite më parë dhe tani ka filluar të dëmtohet. Para dy viteve, Komuna e Kamenicës ka investuar edhe në pjesën rrugore që lidh fshatrat e kësaj komune me ato të Novobërdës dhe në këtë mënyrë aksi rrugor Kamenicë-Llabjan (magjistralla Gjilan-Prishtinë) është kompletuar. Kjo ka bërë që edhe komunikacioni të rritet në këtë pjesë. Por, terreni malor dhe mosmirëmbajtja e rrugëve, e bën të vështirë qarkullimin e automjeteve në stinë të dimrit. Problemi më i madh shfaqet për mjetet transportuese me peshë më të rëndë. Për shkak të këtyre problemeve dhe numrit të vogël të popullsisë, agjencionet private për transportimin e udhëtarëve nuk e shohin të arsyeshme që të operojnë edhe në këtë pjesë. Disa vite më parë, një agjencion nga komuna e Kamenicës kishte lëshuar dy autobus Kamenicë-Novobërdë-Gjilan, dhe anasjelltas. Mirëpo për shkak të mungesës së përfitimit material, qarkullimi i autobusëve është ndërprerë. Si pasojë, banorët e Novobërdës tani përballen me mungesë të transportit publik. Shumë nxënës të kësaj komune zhvillojnë mësimin në shkollat e Kamenicës dhe Gjilanit. Vështirësitë më të mëdha me të cilat ata përballen është mungesa e transportit. Këtë vit komuna e Novobërdës ka bërë një zgjidhje të përkohshme, ku ka angazhuar tre autobusë të cilët qarkullojnë në tri intervale të ndryshme kohore. Dy prej tyre bartin qytetarët serb, dhe një ata shqiptarë. Këto linja të autobusëve kanë lehtësuar në masë të madhe qarkullimin e banorëve. Mirëpo edhe më tutje oraret e qarkullimit janë të pakta dhe nuk dihet nëse ky projekt i komunës do të zgjat edhe gjatë sezonit të dimrit dhe në vitet e ardhshme. Novobërda dhe Dragashi janë dy komunat e Kosovës qytetarët e të cilave përballen me mungesë të transportit publik.

**Ujërat e zeza dhe mbeturinat.** Në disa lokalitete të komunës mungon rrjeti i kanalizimit. Fshatrat Izvor dhe Jasevik përballen më shumë me këtë problematikë. Edhe mbeturinat paraqesin problem të madh në këtë komunë. Afër ndërtesave kolektive në Novobërdë, edhe pse janë të vendosur kontejnerët, mund të hasen deponi të shpeshta bërlloku. Lokalitetet tjera nuk kanë fare kontejnerë dhe mbeturinat hidhen në natyrë. Komuna nuk ka plan për menaxhimin e mbeturinave. Pasi që Novobërda ka një terren të përshtatshëm për zhvillimin e turizimit malor dhe kampingjeve, mbeturinat në masë të madhe dëmtojnë bukuritë natyrore të kësaj komune.

**Gurëthyesi.** Në një nga pjesët më të bukura natyrore të Novobërdës, në afërsi të Kalasë, zhvillon punimet një gurëthyesi. Leja e punës këtij gurëthyesi i është dhënë nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Puna që është zhvilluar deri më tani ka dëmtuar në mënyrë të pa riparueshme ambientin përreth. Vlen të përmendet se zona ku tani zhvillon punimet ky gurëthyesi, në vitin 1994 është klasifikuar si zonë e veçantë topografike dhe nuk lejohet ndërtimi apo gërryerja e tokës.

**Mungesa e përkujdesjes ndaj objekteve historike.** Atraksionin më i madh turistik që ndodhet në këtë komunë është Kalaja e Novobërdës. Mirëpo ky objekt është pa përkujdesje institucionale. Përreth tij hasen mbeturina të shumta dhe nuk është investuar asgjë në drejtim të mirëmbajtjes së mureve që po rrënohen ditë e më shumë. Edhe objektet tjera historike nuk kanë përkujdesjen e duhur institucionale.

## Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në mandatin e parë qeverisës (2000-2002) kryetar komune ka qenë Emin Gërbeshi nga radhët e PDK. Pas zgjedhjeve të dyta lokale, kur qytetarët serb dolën në zgjedhje, kryetar komune u zgjodh Tihomir Bogdanovic nga Koalicioni Kthimi (KP). Në zgjedhjet e treta, të cilat u bojkotuan nga votuesit serb, kryetar komune u zgjodh Bajrush Ymeri nga LDK. Bajrush Ymeri është njëri nga kryetarët e paktë i cili arriti që të siguroj fitoren që në raundin e parë të zgjedhjeve më 17 nëntor 2007. Ai fitoi 560 vota apo 61.47%.

Kapacitetet financiare të komunës së Novobërdës janë shumë të vogla, andaj edhe premtimet e kryetarit të komunës kanë qenë të vogla dhe zakonisht lidhen me ndihmën e nivelit qendror apo donacioneve ndërkombëtare. Në tabelën më poshtë kemi paraqitur disa nga premtimet e dhëna në fushatën zgjedhore 2007 nga kryetari aktual në debatet “Jeta në Kosovë”.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Multietniciteti i komunës do të përdoret si fushatë për thithjen e donacioneve	Gjatë këtyre dy viteve, ka pas investime nga KFOR-i turk në oborrin e shkollës “Minatori”; AER ka ndihmuar në përpilimin e planit zhvillimor; IOM është duke investuar në fazën e katërt në zhvillimin e pjesëve rurale; MercyCorp ka investuar në tregun multietnik; Qeveria e Kosovës është duke ndërtuar 29 shtëpi të banorëve.
Zbutja e papunësisë, ku komuna së bashku me Ministrinë e Bujqësisë do të kujdesen që të punësoj rininë në bujqësi;	Nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.
Gëlqerosja e shkollës në Llabjan dhe shkollat të kenë lëndë djegëse për nxehje në ditën kur fillon sezoni i ngrohje, më 15 tetor e jo më vonë;	Projekti nuk është përbushur në tërësi. Është bërë vetëm pastrimi kimik i shkollës, kurse kanë munguar mjetet financiare për gëlqerosje.
Krijimi i kushteve për aktivitete kulturore;	Premtim është realizuar. Janë bërë renovime në Shtëpinë e Kulturës.
Realizim të projekteve në Llabjan, Prekovic, Bostan dhe Jasonevik.	Premtim është mbajtur. Ka pas investime në të gjitha këto lokalitete.

## Zgjedhjet lokale në Novobërdë

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale në Komunën e Novobërdës, votuesit serb kanë marrë pjesë në votime vetëm në zgjedhjet e dyta lokale më 2002. Pasi që gjysma

e popullsisë së kësaj komune janë serb, mos pjesëmarrja e tyre në zgjedhje ka vështirësuar në masë të madhe punën e Kuvendit Komunal dhe administratës. Në KK të Novobërdës në këto tri mandate kanë mund të zënë vend 17 përfaqësues. Në mandatin e ardhshëm do të jenë 15, dhe Novobërda së bashku me KK të Junikut, Mamushës dhe Hanit të Elezit do të kenë numrin më të vogël të ulëseve në krahasim me kuvendet e komunave tjera.

Në mandatin e parë qeverisës, PDK ka mbajtur numrin më të madh të ulëseve në KK. Dy partitë tjera të përfaqësuara kanë qenë LDK (7 vende) dhe AAK (1 vend). Në zgjedhjet e dyta lokale, me pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhje, shumica qeverisëse në KK i takoi koalicionit të katër partive serbe të cilat së bashku fituan 10 ulëse. Në zgjedhjet e treta lokale, serbët sërish i bojkotuan zgjedhjet. Rezultati i zgjedhjeve nxori PDK-në si partinë më të madhe në Kuvend Komunal; LDK u radhit e dyta dhe LDD e treta. Por ky rezultat i zgjedhjeve nuk u pranua nga PSSP. PSSP me vendimin 2007/63 emëroi dhjetë serb në Kuvendin Komunal të Novobërdës dhe shtatë shqiptarë (3 nga LDK, 3 PDK dhe 1 LDD). Edhe përkundër këtij vendimi, përfaqësuesit e emëruar serb nuk kanë marrë pjesë në mbledhje të KK. KK nuk ka mund ta siguroj kuorumin e nevojshëm për mbajtjen e mbledhjeve konform Ligjit për vetëqeverisje lokale. Tabela më poshtë paraqet partitë politike të cilat kanë siguruar ulëse në KK në tri mandatet e gjertanishme.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Novobërdës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	400	9	567	4	416	8
LDK	336	7	407	3	341	7
AAK	66	1	-	-	-	-
LDD	-	-	-	-	84	2
“Povratak”	-	-	551	4	-	-
DCC	-	-	206	2	-	-
DZZ	-	-	350	3	-	-
KOC	-	-	67	1	-	-

Numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Në zgjedhjet e para më 2000 pjesëmarrja ishte 89.8%. Dy vite më vonë, numri i votuesve me të drejtë vote dhe numri i votuesve që dolën në votime u rritën dukshëm. Por përqindja e pjesëmarrjes në votime ra në 80.7%. Në zgjedhjet e treta, kur sërish qytetarët serb nuk morën pjesë në zgjedhje, numri i votuesve ra në 34.4%. Në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009, numri i votuesve me të drejtë do të rritet dukshëm dhe do të jetë 7,940. Kjo vie si rezultat i asaj se 12 lokalitete të reja do ti bashkëngjiten komunës së Novobërdës. Qytetarët shqiptarë të lokaliteteve që dikur kanë qenë pjesë e komunës së Gjilanit, kanë deklaruar se nuk do ti përgjigjen ftesës për pjesëmarrje në zgjedhje, ngase nuk e ndjejnë veten pjesë e komunës së Novobërdës por asaj të Gjilanit.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Novobërdë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007	2009
Votues me të drejtë vote	918	2769	2456	7940
Pjesëmarrja në votime	824	2236	844	-
Përqindja e daljes në votime	89.8%	80.7%	34.3%	-

## Buxheti i Komunës

Komuna e Novobërdës është një nga komunat me buxhetin më të ulët. Buxheti i vitit 2009 kap shumën prej 1,018,739 €. Edhe pse kjo komunë ka numrin më të vogël të punonjësve në arsim, shëndetësi dhe administratë, pjesa më e madhe e buxhetit shpenzohet për rroga dhe mëditje. Me rritjen e buxhetit të përgjithshëm, janë rritur edhe kategoria për paga dhe meditje, shpenzime komunale dhe mallra dhe shërbime.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	€611,104	€68,519	€25,399	€2,000	€311,717	€1,018,739
2008	€442,469	€66,186	€18,564	-	€20,125	€547,344
2007	€439,862	€61,141	€19,250	€15,000	€61,215	€596,468
2006	€924,627	€174,587	€42,500	-	€68,089	€1,209,803
2005	€447,883	€110,516	€34,739	€3,664	€100,000	€696,802
2004	€432,755	€204,117	-	-	-	€636,872
2003	€313,628	€183,814	-	-	-	€497,442

Buxheti i vitit 2008 prej 547,344 € është shpenzuar 81%. Në gjashtëmujorin e parë të 2009, buxheti është shpenzuar 23.7%. Buxheti i vitit 2010 do të jetë 1,460,465 €. Kurse buxheti i përgjithshëm për tri vite (2010-2012) pritet të jetë 4,483,253 €. Komuna e Novobërdës ka një shkallë të ulët të të hyrave vetanake. Në vitin 2008 të hyrat kanë qenë 16,700 €, apo vetëm 52.9% e të hyrave të planifikuara. Edhe në vitin 2009 të hyrat nuk janë arkëtuar sipas planit. Në gjashtë mujorin e parë të 2009 komuna ka arkëtuar vetëm 34% të mjeteve të planifikuara dhe është një ndër tri komunat që kanë arritur të arkëtojnë më së paku të hyra.

## Investimet kapitale

Buxheti i destinuar për investime kapitale në fillim të vitit 2008 ishte paraparë të jetë 20,125 €, por më vonë kjo shumë është zvogëluar në vetëm 4,000 €. Në vitin 2009, investimet kapitale janë rritur dukshëm dhe këtë vit përbën 30.5% të buxhetit të përgjithshëm. Tabela më poshtë paraqet projektet e përfunduara në 2008 dhe disa nga projektet e 2009.

Tab.5.: Investimet kapitale në Novobërdë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Mirëmbajtja e shkollave	1,200 €
2008	Mirëmbajtja e rrugëve	862 €
2008	Tregu i gjelbër	1,938 €
2009	Asfaltimi i rrugës Lak-Bunjak	76,089 €
2009	Asfaltimi i rrugës Prekovc-Qestak	11,000 €
2009	Asfaltimi i rrugës Prekovc-Qukë	11,000 €

Buxheti i 2008 për investime kapitale është shpenzuar në tërësi gjatë 2008. Kurse buxheti i 2009 për këtë kategori në periudhën janar-qershor nuk është shpenzuar aspak, kështu që të gjitha projektet pritet të fillohen në pjesën e dytë të vitit.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Novobërdës 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	1,460,465	1,484,146	1,538,642
Të hyrat vetanake në €	26,421	27,263	28,045
Investimet kapitale në €	682,440	706,121	760,617

Kuvendi Komunal i Novobërdës ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, Komuna e Novobërdës do të ketë në dispozicion 2,149,178 € për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Novobërdës për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion përafërsisht 3 milion € për investime kapitale.

## Administrata komunale

Në sektorin publik komunal të Novobërdës janë të punësuar 157 qytetarë (arsim, shëndetësi dhe administratë).

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Novobërdës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	157
2008	163 ■
2007	163
2006	176
2005	180
2004	185 ▲
2003	146 ■

Nuk dihet se sa prej këtyre punonjësve punojnë në administratën publike. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shërbimeve Publike në administratën lokale të Novobërdës janë të punësuar 44 qytetarë. Kurse sipas të dhënave të komunës janë të punësuar 62 qytetarë. Sipas vendimit 10/46 të Qeverisë së Kosovës, komunat me më pak se

100,000 banorë duhet të kenë të punësuar një shërbyes civil për 620 banorë. Sipas kësaj del se administrata komunale e Novobërdës do të duhej që të kishte vetëm 16 shërbyes civil. Mirëpo, po në të njëjtin vendim thuhet se asnjë komunë nuk duhet të ketë më pak se 55 punonjës në administratën komunale. Numri prej 55 punonjësve është i domosdoshëm me qëllim që të mund të mbulohen të gjitha funksionet në kuadër të një administrate lokale. Novobërda ka numrin më të madh të shërbyesve civil për kokë banori.

E tërë administrata është e vendosur në një objekt të vetëm dhe hapësira është e përshtatshme për punë dhe për pritjen e palëve. 34 nga punonjësit janë serb, mirëpo pas 17 shkurtit 2008 asnjëri nga punëtorët serb të administratës nuk është paraqitur në punë. Kjo ka ndikuar që administrata të jetë e përgjysmuar në staf dhe rrjedhimisht edhe në kryerjen e punëve. Kryetari i komunës iu ka drejtuar dy herë me një letër dhe i ka ftuar që të kthehen në punë, në të kundërtën ata do të humbin vendet e punës, mirëpo punonjësit serb vazhdojnë të mos paraqiten në punë. Zëvendësimi i tyre me punonjës të ri nuk është lejuar nga UNMIK-u, por masa e vetme ndëshkimore është ndërprerja e pagës.

Vetëm dy shërbyes civil janë me shkollim universitar. Edhe femrat janë të nën përfaqësuar në administratën komunale. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shërbimeve Publike janë të punësuar vetëm 8 femra.

## **Komuna e Novobërdës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale**

Komuna e Novobërdës nuk ka mund ti kryej të gjitha obligimet që kërkohen me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Kjo për arsye të njohura politike. Kuvendi Komunal i gjatë 2008 ka mbajtur tetë mbledhje të rregullta, apo dy më pak se që kërkohen me Ligjin për vetëqeverisje lokale (6 mbledhje janë mbajtur në pjesën e parë të 2009). Mirëpo mbledhjet e KK nuk janë mbajtur konform ligjit, ngase në mungesë të përfaqësuesve të komunitetit serb, në asnjërin prej këtyre mbledhjeve nuk është arritur kuorumi prej 9 anëtarëve. Kuvendi Komunal nuk ka mund të zgjedh as kryesuesin e tij. Në 2008 janë miratuar katër rregullore. Komiteti për politikë dhe financa ka mbajtur vetëm pesë mbledhje gjatë 2008 dhe 6 në pjesën e parë të 2009. Kryetari i komunës së Novobërdës ka mbajtur dy tubime publike më 2008 dhe një në 2009.

Komuna e Novobërdës është një ndër pesë komunitat e Kosovës e cila nuk ka uebfaqe zyrtare.

## **Gjendja në arsim**

Në këtë komunë nuk funksionon asnjë çerdhe. Ekzistojnë pesë shkolla fillore, (2 shkolla amë dhe tri paralele) dhe një shkollë e mesme. Të gjitha shkollat fillore janë shkolla në gjuhën shqipe. Me investim të MASHT, është ndërtuar shkolla e mesme ekonomike në fshatin serb Bostane. Janë bërë intervenime në shkollën fillore në Llabjan dhe Novobërdë, investim i komunës në bashkëpunim me OSBE dhe USAID. KFOR-i turk ka dhënë një donacion për rregullimin e një parku të lojërave për fëmijë në shkollën "Minatori". Janë ndërtuar sistemet e ngrohjes në shkollat në Jasevik,

Prekoc dhe Llabjan. Në konkursin për përzgjedhjen e kuadrit mësimor nuk ka pasur ankesa, mirëpo një nga problemet më madhore të kësaj komune është edhe mungesa e stafit me kualifikim superior.

## Gjendja në shëndetësi

Në Novobërdë ekziston një Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe tri punkte shëndetësore. Nga 16 punonjësit në sistemin shëndetësor komunal, vetëm dy prej tyre janë me shkollim superior. Tërë komunën e mbulojnë vetëm dy mjek specialist. Kushtet e punës në këto punkte shëndetësore janë të rënda dhe qytetarët e Novobërdës zakonisht shërbimet mjekësore i kryejnë në Gjilan. Orari i punës në të gjitha punktet shëndetësore është nga ora 8.00 deri në orën 16.00. Pas kësaj kohe, qytetarët duhet që të kërkojnë shërim në qendrat spitalore në Gjilan dhe Prishtinë. Edhe pse ekziston karrigia stomatologjike, në mungesë të stomatologut ajo nuk është funksionale.

Gjatë dy viteve të fundit, janë bërë disa investime të vogla në fushën e shëndetësisë. Është rregulluar autoambulanca (i janë ndërruar gomat), është bërë regjistrimi i një autoambulance në Prekoc. Është rregulluar laborator i për bërjen e analizave dhe janë pajisur ambulancat me nxehje qendrore.

## Shoqëria civile

Organizatat e shoqërisë civile janë të pakta në numër dhe nuk janë mjaft aktive. Ekzistojnë dy OJQ që merren me aktivitete të kohëpaskohshme. “Rrjeti rinor” është organizatë që merret me aktivitete rinore, kurse “Iliria” është shoqatë e grave. Një nga organizatat më aktive e cila promovon turizmin është “Rural Tourism Novo Brdo” ([www.tourism-novobrd.com](http://www.tourism-novobrd.com)). Po ashtu komunë është edhe OJQ nga Gjilani, Aksioni për Ndërtimin e Paqes.

## Mediat lokale

Ekziston vetëm një radio lokale, “Youth Voice”. Kjo radio funksionon në bazë të donacioneve dhe është radio multietnike. Mënyerë tjetër, në mungesë të donacioneve, radio nuk funksionon. Lajmërimet kryesisht bëhen me pllakate. “Intercooperation” nga Zvicra financon botimin e një informatori për aktivitetet e komunës, mirëpo në mungesë të gazetarëve, përgatitja e informatorit bëhet nga ana e klubit të gazetarëve “D-Press” nga Kamenica.

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlligjariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë të vjetore në shkallën prej 0.05% dhe 1% të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj, Kuvendi

Komunal i Novobërdës ka miratuar edhe Rregulloren komunale për tatim në pronë, sipas së cilës është caktuar vlera e pronës në treg, norma tatimore dhe zonat e komunës.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Novobërdës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
<b>Norma tatimore</b>					
	0.10%	0.10%	0.20%	0.15%	0.075%
<b>Vlera e tregut për metër katror</b>					
<b>Zona</b>					
I	220€	220€	250€	240€	150€
II	200€	200€	230€	220€	130€
III	180€	180€	210€	200€	-

## Kostoja për biznese

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë janë të regjistruara 69 biznese nga komuna e Novobërdës. Mirëpo sipas të dhënave të komunës, vetëm 35 prej tyre janë aktive. Me Rregulloren komunale për tarifën, ngarkesat dhe gjobat, Kuvendi Komunal ka caktuar tarifën vjetore për të gjitha bizneset që aplikojnë për leje pune. Në tabelën më poshtë kemi përshkruar disa prej tyre.

Tab.9. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	100 €
Kompanitë e sigurimit	150 €
Hotelet	150 €
Motelet	100 €
Supermarketet-Hipermarketet	150 €
Vetëshërbimet - Minimarketet	80-100 €
Restorantet	100 €
Barnatoret	80 €
Gurthyesit	300 €
Autoshkollat	100 €
Depot e materialit ndërtimore	100 €
Auto-taxit	100 €
Transporti publik	100 €
Shitoret	50 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	50-80 €
Ndërmarrjet ndërtimore	100-150 €
Agjencitë turisitke	40-60 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	80-100 €

## Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, [www.jetanekosove.com](http://www.jetanekosove.com).
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. MASHT. Statistikat e Arsimit në Kosovë. Prishtinë, 2009.
13. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
14. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
15. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
16. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.